

Vlerësimi i industrisë së përpunimit të pemëve dhe perimeve në Kosovë 2019/2020

Mbështetur nga:



Tabela e përmbajtjes

Lista e Tabelave	3
Lista e Figurave.....	3
Përmbledhja ekzekutive	4
Shoqata e Përpunuesve të Pemëve dhe Perimeve – PePeKo	5
Hyrja	6
Metodologjia	7
Përmbledhje e Zhvillimit të Sektorit.....	8
Rezultatet kryesore të studimit.....	12
Punësimi në industrinë e përpunimit të pemëve dhe perimeve.....	12
Implementimi i Standarteve të Sigurisë së Ushqimit.....	13
Kapacitetet prodhuese dhe përpunuese të kompanive të përpunimit të pemëve dhe perimeve.....	14
Furnizimi me lëndë të parë	15
Investimet dhe investimet e planifikuara në sektor.....	16
Shitjet: Vendore dhe Eksporti.....	18
Konkurrenca e tregut dhe aktivitetet e promovimit	19
Ndikimi i Pandemisë COVID-19 në sektor	20
Pengesat kryesore të sektorit.....	20
Rekomandimet	22
Konkluzionet.....	24
Literatura.....	26

Lista e Tabelave

Tabela 1: Totali i tokës së punueshme të përdorur 2019	8
Tabela 2: Sipërfaqja e kultivuar me perime dhe pemë	9
Tabela 3: Sipërfaqja e kultivuar me kulturat kryesore të perimeve	10
Tabela 4: Sipërfaqja e kultivuar me kulturat kryesore të pemëve	10
Tabela 5: Sipërfaqja dhe prodhimi i Pemëve dhe Perimeve në Kosovë	11
Tabela 6: Numri i punonësorëve që punojnë në subjektet e kompanive të intervistuar.....	12
Tabela 7: Implementimi i Standarteve Të Sigurisë së Ushqimit	13
Tabela 8: Kapacitete prodhuese dhe përpunuese	14
Tabela 9: Grumbullimi i Pemëve dhe Perimeve për vitet 2019 / 2020.....	15
Tabela 10: Investime dhe investimet e planifikuara në sektor.....	16
Tabela 11: Shitjet, shitjet lokale dhe eksportuese	18

Lista e Figurave

Figura 1: Struktura e sipërfaqes së kultivuar me perime	9
Figura 2: Struktura e sipërfaqes së kultivuar me pemë.....	9
Figura 3: Sipërfaqja e kultivuar me kulturat kryesore të perimeve	10
Figura 4: Sipërfaqja e kultivuar me kulturat kryesore të pemëve.....	11
Figura 5: Certifikimi për Standarde të Sigurisë Ushqimore	14
Figura 6: Kapacitete prodhuese dhe përpunuese	14
Figura 7: Furnizimi me lëndë të parë.....	15
Figura 8: Furnizimi me lëndë të parë nga kompanitë*%.....	16
Figura 9: Investimet në industrinë e përpunimit të pemëve dhe perimeve	17
Figura 10: Shitjet totale 2019 / 2020.....	18

Përmbledhja ekzekutive

Shoqata e Përpunuesve të Pemëve dhe Perimeve të Kosovës “PePeKo” ka realizuar një vlerësim të zinxhirit të vlerës së sektorit të pemëve dhe perimeve në Kosovë për dy vite - 2019 dhe 2020. Për të arritur qëllimin e këtij studimi, hulumtimi është bazuar në rezultatet e studimeve në tryezë (dytësore) dhe përmes intervistave të strukturuar të cilat janë realizuar në 24 kompani, anëtare të shoqatës PePeKo. Hulumtimi i tryezës është përqendruar kryesisht në mbledhjen e të dhënave dytësore statistikore në lidhje me zhvillimin e bujqësisë për dy vitet e fundit nga Agjencia e Statistikave të Kosovës dhe Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, si dhe krahasimi i raporteve të fundit të vlerësimit të Zinxhirit të Vlerës të realizuara nga shoqata PePeKo. Intervistat e strukturuar janë realizuar me anëtarët e shoqatës PePeKo dhe kompani të tjera të përpunimit të pemëve dhe perimeve. Shkalla e pjesëmarrjes së kompanive të zgjedhura në hulumtim ka qenë rreth 95% dhe kjo mostër është një përfaqësim i mirë i sektorit.

Nga intervistat e realizuara me anëtarët e shoqatës PePeKo, shumica e tyre besojnë se pagesa e TVSH-së për lëndët e para, mungesa e lëndëve të para të industrisë, vendosja e produkteve të tyre në tregjet e huaja dhe BE-së, vonesat në pagesa nga shitësit vendor dhe konkurrenca e padrejtë nga produktet e importuara po e dëmtojnë shumë këtë industri. Kapaciteti i deklaruar i prodhimit dhe përpunimit është rreth 50.000 tonë pemë dhe perime. Mesatarisht kompanitë operojnë me 50% të kapacitetit të tyre, por kjo vlerë ndryshon ndërmjet kompanive ku disa kompani përdorin më pak se 25% të kapaciteteve, dhe disa të tjera nuk kanë kapacitete të mjaftueshme për të përmbushur nevojat e tregut. Të gjitha kompanitë së bashku kanë rreth 33,450 m² objekte të punës me temperaturë dhome, 20,000 m² dhoma ftohëse dhe deri në 250 m² dhoma ngrirjeje.

Shumica e anëtarëve të PePeKo-së kryesisht furnizohen me lëndë të parë nga prodhuesit vendorë, prej të cilëve 13 kompani blejnë 100% të lëndës së parë nga furnizuesit vendorë, dhe pjesa tjetër kombinojnë lëndën e parë vendore dhe të importuar, siç tregohet në Figurën 9. Përveç kësaj, kompanitë e përpunimit të pemëve dhe perimeve kanë deklaruar furnizimin me lëndë të para për dy vite: për vitin 2019 ishte rreth 23,000 ton dhe për vitin 2020 rreth 34,000 ton.

Vlera totale e investimeve të deklaruar nga kompanitë e intervistuar për vitet 2019 dhe 2020 është rreth 8 milion Euro, ku rreth 60% e investimeve janë alokuar për linjat e përpunimit, 30% e investimeve në objektet e punës dhe magazinimit, dhe pjesa tjetër e investimeve në dhomat e ftohjes me temperaturë të kontrolluar, si dhe investime në automjete transportuese. Disa nga ndërmarrjet e intervistuar besojnë se ato do të rrisin kapacitetet e tyre në të ardhmen, kryesisht për shkak të rritjes së kërkesës, çasjes më të mirë në treg, rritjes së prodhimit dhe përmirësimit të cilësisë. Bazuar në të dhënat e mbledhura nga terreni, të gjithë anëtarët e PePeKo-së në vitin 2019 kanë punësuar 1,997 punëtorë, 57% e të cilëve ishin punëtorë me kohë të plotë dhe pjesa tjetër të punësuar me kohë të pjesshme për rreth 130 ditë në vit ose 4 muaj. Në vitin 2020, numri i përgjithshëm i të punësuarve ishte 2,029, ku raporti midis punëtorëve me kohë të plotë dhe atyre me kohë të pjesshme ishte i njëjtë me vitin 2019.

Një nga sfidat e identifikuara ishte gjetja e profileve profesionale të burimeve njerëzore kryesisht në fushat e inxhinierisë mekanike dhe elektrike, teknolog të kualifikuar të ushqimit, mirëmbajtjes së makinerive dhe shitjeve. Një sfidë tjetër në vitin 2020 ishin masat kufizuese si pasojë e COVID-19, gjë që ka penguar shitjet e produkteve në tregun lokal, por shumica e kompanive përpunuese kanë organizuar një furnizim më të mirë me lëndë të parë për përpunim, dhe kanë rritur shitjet në eksport në shtetet e BE-së si rezultat i prishjes së zinxhirit të furnizimit në vendet e ndryshme evropiane.

Shoqata e Përpunuesve të Pemëve dhe Perimeve – PePeKo

Shoqata e përpunuesëve të pemëve dhe perimeve PePeKo, është një shoqatë jofitimprurëse e themeluar në vitin 2014. Objektivi kryesor i shoqatës është mbrojtja e interesave të përpunuesve vendorë, në mënyrë që të zhvillojë më tej industrinë e përpunimit të pemëve dhe perimeve, për të kontribuar në rritjen ekonomike dhe punësim, përmes zhvillimit të zinxhirit të vlerës në sektorin e pemëve dhe perimeve në Kosovë. Shoqata PePeKo është një përfaqësuese e sektorit të përpunimit të pemëve dhe perimeve në Kosovë, ku aktualisht përfaqëson rreth 20 kompani të përpunimit të pemëve dhe perimeve në vend të cilat furnizohen kryesisht nga prodhuesit vendorë të pemëve dhe perimeve.

Objektivat kryesorë të shoqatës janë:

- Të mbrojtë interesat e industrisë së përpunimit të pemëve dhe perimeve;
- Të rris kapacitetet përpunuese të kompanive vendore dhe të përmirësojë cilësinë e produkteve të përpunuara vendore;
- Të mbështesë anëtarët e shoqatës për të gjetur tregje të reja eksporti;
- Të marrë pjesë në grupe pune të organizuara nga institucionet lokale në lidhje me legjislacionin dhe çështje të tjera për industrinë e përpunimit të ushqimit.

Gjithashtu, shoqata organizon aktivitetet e më poshtme si:

- Takime koordinuese me palët kryesore të interesit nga sektori;
- Aplikim i përbashkët për të mbështetur dhe organizuar zinxhirin e vlerës në industrinë e përpunimit të ushqimit;
- Organizimi i vizitat në vendet e rajonit dhe BE-së për të gjetur tregje të reja;
- Organizimi i pjesëmarrjes në panairë ndërkombëtare që lidhen me industrinë e përpunimit të ushqimit;
- Aktivitete të tjera me qëllim të mbrojtjes së prodhuesve vendorë nga konkurrenca e pandershme.

Bazuar në aktivitetet e organizuara nga Shoqata PePeKo, si dhe prezantimi i duhur i sektorit të përpunimit të pemëve dhe perimeve, gjatë dy viteve të fundit, interesimi i kompanive të përpunimit për të qenë anëtarë të PePeKo-së është rritur. Tani ekzistojnë 20 kompani përpunuese që vazhdimisht marrin pjesë në aktivitetet e shoqatës. Kjo iniciativë do të sigurojë që Shoqata kosovare e përpunimit të pemëve dhe perimeve të jetë plotësisht operacionale dhe e forcuar, në mënyrë që të ofrojë shërbime për anëtarët e saj. Shoqata ka treguar potencialet e saj dhe nevojën për subjekte të tilla në këtë sektor. Sidoqoftë, përvoja e kaluar dhe mos ekzistenca e një forme të tillë përfaqësimi ka penguar zhvillimin e grupeve të tilla.

Kompanitë lokale kanë identifikuar nevojën dhe rëndësinë që të organizohen si një grup interesi për të qenë më përfaqësues dhe më të fuqishëm. Shoqata e përpunuesve të pemëve dhe perimeve është një faktor shumë i rëndësishëm në ekonominë e Kosovës që përfaqëson një urëlidhëse për më shumë se 10,000 prodhues të pemëve dhe perimeve dhe konsumatorëve në tregun vendor dhe ndërkombëtar. Duke zbatuar aktivitete të tilla dhe duke qenë përfaqësuese e sektorit, Shoqata do të forcohet dhe do të jetë në gjendje të vazhdojë kontributin e saj në zhvillimin e sektorit të pemëve dhe perimeve në Kosovë.

Hyrja

Qëllimi kryesor i hulumtimit është mbledhja dhe shpërndarja e informacioneve mbi zhvillimin e sektorit për vitet 2019 dhe 2020. Temat me më shumë fokus në këtë studim ishin:

- Zhvillimi i sektorit për dy vitet e kaluara;
- Situata aktuale e kapaciteteve prodhuese dhe përpunuese primare në Kosovë;
- Situata aktuale e tregut dhe eksportit;
- Analizat e punësimit dhe potenciali për krijimin e vendeve të punës;
- Analiza e mjedisit të biznesit për sektorin.

Ky raport është bazuar në mbledhjen e të dhënave ekzistuese dhe statistikave të publikuara dhe të përpiluara nga institucionet përkatëse dhe të besueshme siç janë Agjencia e Statistikave të Kosovës dhe Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, si dhe studimet e mëparshme të kryera për këtë sektor. Bazuar në të dhënat e Raportit të Gjellbër të vitit 2020 të publikuar nga MBPZhR, sipërfaqja totale e shfrytëzuar e tokës bujqësore nuk ka ndryshuar në mënyrë të ndjeshme dhe tendenca e shfrytëzimit të tokës ishte pothuajse e njëjtë për këtë periudhë kohore. Në vitin 2016, sipërfaqja totale e shfrytëzuar e tokës bujqësore ishte 415,826 ha, ndërsa në 2017 kishte një rritje të lehtë, duke vazhduar të rritet në vitin 2018 ku sipërfaqja ishte 418,582 ha. Rritja e përdorimit të tokës bujqësore vazhdoi në vitin 2019 dhe në këtë rast sipërfaqja arriti në 420,141 ha, që tregon një ndryshim në vitin 2019 krahasuar me vitin 2018 për 0.4%.

Sipërfaqja më e madhe e tokës së shfrytëzuar është e zënë nga livadhet dhe kullosat (përfshirë tokën e zakonshme) që zë 51.9% të sipërfaqes totale të shfrytëzuar të tokës bujqësore. Pas livadheve dhe kullosave, sipërfaqja më e madhe në vitin 2019 ishte toka e punueshme, me një pjesëmarrje prej 44.8%, e cila përfaqëson sipërfaqen prej 188,365 ha (përfshirë edhe perimet në fushë të hapur dhe serrat). Sipërfaqja e tokës së punueshme me perime në fushë të hapur dhe në serra për vitin 2019 ishte 8,836 ha, ku 8,319 hektarë ishin perime në fushë të hapur, ndërsa 517 hektarë serra. Në vitin 2019, sipërfaqja e perimeve në krahasim me vitin 2018 është rritur për 6.4%, ndërsa sipërfaqja e plantacioneve të pemëve në vitin 2019 ishte 9,244 hektarë, dhe krahasuar me vitin 2018 sipërfaqja e përgjithshme e plantacioneve të pemëve është rritur për 20.3%.

Sipas të dhënave të raportuara në Raportin e Gjellbër të vitit 2020 (të dhënat që paraqesin zhvillimin për vitin 2019), PBB-ja e Kosovës është 7.1 miliardë Euro, dhe bujqësia merr pjesë me 7.6% ose 545.2 milion Euro. Për më tepër, sipas të dhënave të Agjencisë së Statistikave të Kosovës, rritja reale e bujqësisë ishte 8%. Në vitin 2019, rreth 92,769 ton të pemëve dhe perimeve të freskëta janë importuar me një vlerë mbi 38 milion Euro. Importi i pemëve zë rreth 39%, ndërsa vlera e pemëve të importuar është rreth 13 milion € nga sasia totale e importuar. Importet e perimeve të freskëta marrin pjesë me 61% të sasisë totale të importuar ose rreth 25 milion € nga shuma totale e deklaruar.

Eksporti i pemëve dhe perimeve nga Kosova është 13,357 ton ose 3.5 milion €, ku 97% e sasisë totale të deklaruar është e mbuluar nga perimet ose 2.9 milion € nga shuma totale e eksportit të pemëve dhe perimeve. Kosova ka një bilanc tregtar negativ në këtë sektor, ku për sa i përket sasisë eksporti mbulon vetëm 15% të totalit të pemëve dhe perimeve të importuara, dhe vlera (në Euro) e eksportit mbulon vetëm 10% të vlerës totale të importuar të pemëve dhe perimeve.

Metodologjia

Metodologjia e përdorur për këtë hulumtim bazohet në dy qasje kryesore të përdorura në studimet e mëparshme në sektorin e pemëve dhe perimeve të përpunuara: intervistat me kompanitë dhe hulumtimet në tryezë (dytësore). Të dhënat e hulumtimit në tryezë janë përdorur nga burime të besueshme të institucioneve publike, të tilla si MBPZhR, ASK, etj. Këto të dhëna u përdorën si sfond konteksti për sektorin.

Të dhënat nga intervistat e strukturuar janë siguruar nga 24 kompani dhe intervistat janë realizuar ballë-për-ballë me pronarët ose menaxherë të nivelit të lartë, në zyrat e të anketuarve. Pyetësi u krijua për të mbuluar objektivat e projektit dhe informacioni shtesë i mbledhur nga kompanitë ka shërbyer si bazë për të përpunuar më tej rezultatet e studimit. Gjatë intervistave kemi mbledhur informacione në lidhje me punësimin, shitjet, eksportin, si dhe të dhëna mbi mbledhjen e pemëve dhe perimeve, investimet, aktivitetet promovuese dhe efektet e Pandemisë COVID-19 në sektor.

Rezultatet e studimit rrjedhin kryesisht nga përgjigjet e kompanive të intervistuar dhe të dhëna dytësore janë përdorur kryesisht për qëllime krahasuese. Shkalla e pjesëmarrjes së kompanive të zgjedhura në hulumtim ishte rreth 95%, duke treguar kështu një gatishmëri të lartë të bashkëpunimit midis akterëve të sektorit.

Përmbledhje e Zhvillimit të Sektorit

Sipas të dhënave të Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, industria e përpunimit të pemëve dhe perimeve në vitet e fundit ka pasur një konsolidim përsa i përket investimeve në asete fizike dhe makineri, por zhvillimi i saj i përgjithshëm ka qenë i ngadaltë. Vështirësitë e këtij sektori janë kryesisht rezultat i ndikimit të faktorëve të ndryshëm si organizimi i zinxhirit të furnizimit, organizimi i shitjes së produkteve, politikat fiskale dhe politikat bujqësore të cilat jo gjithmonë kanë favorizuar prodhuesit vendorë. Përveç këtyre vështirësive të përmendura më sipër, shumë kompani kanë vështirësi në furnizimin e qëndrueshëm të lëndëve të para si rezultat i strukturës së fermave në vendin tonë. Shumica e fermave bujqësore kanë tokë të punueshme prej 2.5 hektarësh e cila së paku ndahet në 5 parcela, gjë që e pamundëson zhvillimin e bujqësisë intensive.

Bazuar në të dhënat e Raportit të Gjellbër të MBPZhR të vitit 2020, numri i të punësuarëve në sektorin e përpunimit të pemëve dhe perimeve është rreth 10,000 punëtorë me ndryshime të lehta gjatë viteve. Vetëm në vitin 2019 në këtë sektor ishin të punësuar rreth 12,467 punëtorë të cilët janë të përfshirë drejtpërdrejt në këtë industri. Nën-sektori i pemëve dhe perimeve në Kosovë përbën rreth 4.5% të të gjithë sektorit të bujqësisë për sa i përket përdorimit të tokës. Kjo përfshin pemë frutore, perime, kopshte, vreshta dhe fidanë. Në vitin 2016, sipërfaqja totale e shfrytëzuar e tokës bujqësore ishte 415,826 ha, ndërsa në 2017 kishte një rritje të lehtë, duke vazhduar të rritet në 2018 ku sipërfaqja ishte 418,582 ha. Rritja e përdorimit të tokës bujqësore vazhdoi edhe në vitin 2019 dhe në këtë rast sipërfaqja arriti në 420,141 ha. Bazuar në Raportin e Gjellbër (2020) struktura e përdorimit të tokës së punueshme në Kosovë përshkruhet në tabelën e më poshtë dhe tregon se pothuajse gjysma e tokës së punueshme përdoret për bujqësi të gjerë përfshirë livadhet dhe kullosat, dhe pjesa tjetër është e ndarë për sektorët tjetër të bujqësisë duke përfshirë prodhimin e perimeve, pemëve frutore, vreshtave, etj.

Tabela 1: Totali i tokës së punueshme të përdorur 2019

Përdorimi total i tokës së punueshme	Sipërfaqja në ha
Toka e punueshme	188,366
-Perimet në fushë të hapur	8,319
-Perimet në serra	518
Kopsht	1,122
Pemë frutore	9,244
Vreshtat	3,367
Fidanët	111
Livadhe dhe kullosa (përfshirë tokën e përbashkët)	217,932
Toka e përgjithshme bujqësore e përdorur	420,142

Burimi: ASK, Rezultatet e Anketës së Pronave Bujqësore, 2019

Bazuar në informacionin e paraqitur nga Agjencia e Statistikave të Kosovës në raportin e Anketave të Ekonomisë Bujqësore për vitin 2019, perimet dhe pemët kryesore të kultivuara janë paraqitur në tabelën më poshtë:

Tabela 2: Sipërfaqja e kultivuar me perime dhe pemë

Zonë e kultivuar me perime dhe pemë kryesore*Ha			
Speca	3,108.15	Mollë	3,006.37
Domate	794.18	Kumbullë	2,096.25
Tranguj	303.76	Mjedër	1,636.82
Lakër	905.85	Pjeshkë	609.86
Qepë	1,354.03	Qershi	232.35
Sipërfaqja e përgjithshme	6,465.97	Sipërfaqja e përgjithshme	7,581.65

Burimi: ASK, Rezultatet e Anketës së Ekonomive Bujqësore, 2019




Figura 1: Struktura e sipërfaqes së kultivuar me perime




Figura 2: Struktura e sipërfaqes së kultivuar me pemë

Sipas të dhënave të mbledhura nga Departamenti për Analiza Ekonomike në Ministrinë e Bujqësisë përmes Anketave Bujqësore në vitin 2019 rendimenti mesatar për hektar në kulturat kryesore të pemëve është 6.40 tonë për hektar, ndërsa për perimet kryesore rendimenti mesatar është 24.03 tonë për hektar. Këto të dhëna janë prezantuar në tabelën vijuese:

Tabela 3: Sipërfaqja e kultivuar me kulturat kryesore të perimeve

Sipërfaqja e kultivuar me kulturat kryesore të perimeve*Ha					
Kultura / Vit	2015	2016	2017	2018	2019
Speca	3,090	3,363	3,035	3,038	3,108
Domate	791	866	862	757	794
Tranguj	317	259	305	273	304
Lakër	594	807	917	832	906
Qepë	1,079	1,228	1,465	1,185	1,354




Figura 3: Sipërfaqja e kultivuar me kulturat kryesore të perimeve

Sidoqoftë, nëse analizojmë zonën e mbjellur me pemë (shkurre frutore), mund të shohim se pemishtet e mollëve, kumbullave dhe mjedrave kanë sipërfaqet më të mëdha dhe kjo për shkak të rritjes nga viti në vit. Në tabelën 4 të paraqitur më poshtë, mund të vërehet rritja vjetore e sipërfaqes së kultivuar.

Tabela 4: Sipërfaqja e kultivuar me kulturat kryesore të pemëve

Sipërfaqja e kultivuar me kulturat kryesore të pemëve*Ha					
Pemë / Vit	2015	2016	2017	2018	2019
Mollë	1,972	2,076	2,155	2,556	3,006
Kumbullë	1,518	1,518	1,524	1,821	2,096
Mjedër	324	797	1,231	1,537	1,637
Dardhë	367	416	456	479	610
Qershi	147	148	149	167	232




Figura 4: Sipërfaqja e kultivuar me kulturat kryesore të pemëve

Tabela 5: Sipërfaqja dhe prodhimi i Pemëve dhe Perimeve në Kosovë

Prodhimi/vit	2015	2016	2017	2018	2019
Sipërfaqja me pemë (Ha)	4,930	5,668	6,422	7,922	9,479
Prodhimi i pemëve (Ton)	44,674	54,836	34,207	53,606	67,294
Sipërfaqja me perimeve (Ha)	14,656	17,395	19,643	17,886	18,911
Prodhimi i perimeve (Ton)	246,096	335,467	358,394	265,420	300,559

Burimi: ASK – Anketa e Ekonomive Bujqësore ('15, '16, '17, '18, and '19);

Rezultatet kryesore të studimit

Punësimi në industrinë e përpunimit të pemëve dhe perimeve

Punësimi është një nga sfidat më të mëdha me të cilat përballet bujqësia viteve të fundit, kjo sfidë gjithashtu ka prekur edhe industrinë e përpunimit. Shumica e ndërmarrjeve përpunuese kanë problem të vazhdueshëm të punësimit të punëtorëve në profileve të ndryshme profesionale, të cilat do të përmenden më poshtë në raport. Edhe pse me shumë vështirësi, të gjitha kompanitë e intervistuar kanë arritur të punësojnë rreth 2,000 punëtorë. Sipas të dhënave të paraqitura në tabelën më poshtë, në vitin 2020 kishte një rritje të lehtë të numrit të të punësuarve në industrinë përpunuese, pavarësisht sfidave të shkaktuar nga COVID-19.

Sipas informacionit të mbledhur lidhur me punësimin në sektorin e përpunimit të pemëve dhe perimeve, kompanitë kanë deklaruar se në vitin 2019 kanë punësuar 1,997 punëtorë, nga të cilët 1,150 (57%) janë punëtorë me kohë të plotë dhe 847 (43%) janë punëtorë sezonalë. Ndërsa në vitin 2020 ka pasur një rritje të lehtë të të punësuarëve dhe bazuar në të dhënat e mbledhura kompanitë kishin 2,029 punonjës, nga të cilët 1,157 (57%) ishin punëtorë me kohë të plotë dhe 872 (43%) ishin punëtorë sezonalë. Nga krahasimi i vitit 2019 dhe vitit 2020, mund të vërehet që nuk ka një ndryshim të madh në numrin e përgjithshëm të të punësuarve që tregojnë një gjendje shumë të qëndrueshme për sa i përket punësimit.

Tabela 6: Numri i punonjësve që punojnë në subjektet e kompanive të intervistuar

Viti	2019	2020	Diferenca në %
Numri total i të punësuarëve	1,997	2,029	1,58
Punëtorët me kohë të plotë	1,150	1,157	0,61
Punëtorët sezonal	847	872	2,95
Gra të punësuar	829	856	3,26
Minoritete	267	262	-1,87
Të kthyerit	10	2	-80

Duke marrë parasysh që vitet e fundit emigrimi i qytetarëve të vendit tonë ka rënë ndjeshëm, të rinjtë kanë përdorur mënyra ligjore për të hyrë në tregun e punës në vendet e BE-së, dhe kjo ka çuar në një **“ikje të trurit”** dhe të fuqisë punëtore në vendin tonë. Përkundër kësaj situate, sektori i përpunimit të pemëve dhe perimeve nuk është prekur aq shumë. Sipas rezultateve të prezantuar ky sektor ka pasur një rritje të lehtë të punësimit në vitin 2020 krahasuar me vitin 2019.

Nga numri i përgjithshëm i të punësuarve rreth 45% janë punëtorë sezonal, shumica e tyre janë të punësuar në periudhën kur kompanitë janë në kulmin e prodhimit dhe nevoja për punëtorë shtesë është mjaft e lartë. Në shumë raste për shkak që kompanitë kanë vështirësi në gjetjen e punëtorëve sezonalë, disa punëtorë sezonalë punësohen gjithashtu edhe në komuna tjera. Bazuar në numrin total të të punësuarve me kohë të plotë dhe sezonal në vitin 2019 rreth 41% e fuqisë punëtore ishin gra, 13.5% nga minoritetet dhe 0.5% ishin të kthyerit. Gjithashtu bazuar në deklaratat e përfaqësuesve të kompanive pothuajse 50% e totalit të të punësuarve ishin të rinj të moshës 18-45 vjeç. Në vitin 2020 nga numri total i të punësuarëve me kohë të plotë dhe sezonal, rreth 856 ose 42% ishin gra, 262 punëtorë nga minoritetet dhe vetëm 2 ishin të kthyerit. Sipas të dhënave të marra nga kompanitë, rreth 57% e numrit total të të punësuarëve ishin të moshës së re mes 18-45 vjeç. Punëtorët sezonal ishin punësuar për periudhë kohore prej 2 deri në 8 muaj, dhe nëse e marrim në mesatare, shumica nga punëtorët sezonal ishin të punësuar për rreth 4.4 muaj ose 130 ditë gjatë vitit.

Kur janë pyetur kompanitë, nëse kanë hasur në vështirësi në gjetjen e punëtorëve të kualifikuar, 20 kompanitë kanë deklaruar se janë ballafaquar me mungesë të punëtorëve të kualifikuar dhe në disa raste kur punëtorë kanë qenë të kualifikuar dhe me përvojë, ata nuk kanë shprehur gatishmëri për të punuar për pagën e ofruar në tregun e punës në Kosovë. Profilet e punëtorëve të kërkuar nga kompanitë që janë vështirë për t'u gjetur janë:

- Teknolog i ushqimit me përvojë;
- Teknik laborator i industrisë ushqimore;
- Teknik i prodhimit;
- Agronom;
- Mirëmbajtësi i pajisjeve të prodhimit;
- Inxhinier elektrik për pajisje industriale;
- Inxhinier mekanik për pajisje industriale;
- Agjentë i shitjes me përvojë;
- Enolog.

Sa i përket nivelit të arsimimit të stafit drejtues të kompanive, më shumë se gjysma e tyre kanë nivel të lartë arsimimi dhe drejtuesit e kompanive kanë të përfunduar masterin. Ndërsa, për nivelin e arsimimit të punëtorëve, 7 kompani kanë nivel të kënaqshëm të arsimimit të punëtorëve, 12 kompani janë të pakënaqura me nivelin e arsimimit të punëtorëve dhe 3 prej tyre kanë deklaruar se të punësuarit kanë nivelin e kënaqshëm të arsimimit për punët që ata bëjnë.

Sidoqoftë, shumica e kompanive të intervistuar deklaruan se ata investojnë vazhdimisht në rritjen e kapaciteteve njerëzore në mënyrë që të përmirësojnë njohuritë e tyre për të dy nivelet e stafit të kompanisë. Trajnimet dhe përmirësimet bazohen në nevojën e kompanive për të rritur arsimimin e stafit drejtues dhe punëtorëve tjerë, duke ndjekur trajnime të ndryshme në lidhje me standardet e sigurisë ushqimore si Praktikat e Mira të Prodhimit (GMP), Praktikat e Mirë të Higjienës (GHP), etj.

Implementimi i Standarteve të Sigurisë së Ushqimit

Kompanitë e përpunimit të pemëve dhe perimeve në Kosovë kanë mbetur mbrapa sa i përket certifikimeve të sigurisë ushqimore. Nga 24 kompani të intervistuar vetëm 5 kompani janë të certifikuar me ISO 22000, 8 kompani me HACCP, 2 kompani me ISO 9001 dhe Global GAP, dhe 2 kompani me IFS. Nga 24 kompani të intervistuar, 12 prej tyre nuk kanë ndonjë standard të sigurisë ushqimore që e zbatojnë në kompanitë e tyre. Në shumë raste kemi kompani që kanë dy ose më shumë standarde të ndryshme të implementuara.

Tabela 7: Implementimi i Standarteve të Sigurisë së Ushqimit

Certifikimi për Standarde të Sigurisë Ushqimore	Numri i kompanive të certifikuar
HACCP	8
ISO 22000	5
ISO 9001	2
IFS	2
HALLALL	1
GLOBAL GAP	2
HACCP në proces të implementimit	2
Nuk kanë certifikim për SSU	12




Figura 5: Certifikimi për Standarde të Sigurisë Ushqimore

Kapacitetet prodhuese dhe përpunuese të kompanive të përpunimit të pemëve dhe perimeve

Kapacitetet e deklaruar të prodhimit dhe përpunimit të kompanive të intervistuar janë rreth 55,000 ton pemë dhe perime në vit. Përdorimi i kapaciteteve në kompani luhetet mes 25% deri në 95%. Nëse marrim një mesatare të përgjithshme të shfrytëzimit të kapaciteteve shihet se shumica e kompanive nuk përdorin më shumë se 50% të kapaciteteve të tyre ekzistuese. Nga të dhënat e mbledhura në lidhje me kapacitetet e kompanive, të gjitha ndërmarrjet së bashku kanë rreth 35,000 metra katrorë objekte pune me temperatura dhome, dhe rreth 20,000 metra katrorë dhoma magazinimi ftohëse prej -20 deri - 40 gradë Celsius.

Tabela 8: Kapacitete prodhuese dhe përpunuese

	Kapacitetet ekzistuese	Kapacitete e shfrytëzuara
Kapaciteti i Kompanive*Ton	54,880	27,988.8
Objekte (Temp. Dhome) m²	33,950	17,314.5
Dhoma ftohëse (- 20 °C.) m²	19,340	9,863.4
Dhoma ftohëse (- 40 °C) m²	250	127.5




Figura 6: Kapacitete prodhuese dhe përpunuese

Furnizimi me lëndë të parë

Shumica e anëtarëve të PePeKo-së kryesisht furnizohen me lëndë të parë nga fermerët lokalë, kështu që, ndikimi i tyre socio-ekonomik është thelbësor në të gjithë zinxhirin e vlerës. Nga të dhënat e mbledhura, besohet se në mënyrë direkt dhe indirekt janë përfshirë më shumë se 5,000 fermerë në të gjithë territorin e Kosovës në këtë sektor. Sasia e perimeve të mbledhura nga kompanitë përpunuese në vend për vitin 2019 ishte 16,081 ton, ndërsa sasia e pemëve ishte 7,500 ton. Perimet kryesore të mbledhura ishin specat Somborka, specat Babura, specat Kurtovska Kapija, domate, tranguj, lakër, lulëlakër, karrota, etj. Ndërsa, pemët kryesore të grumbulluara ishin: mollë, kumbullë, dardhë, vishnje, manaferrë, aroni, dhe mjedër. Nëse krahasojmë grumbullimin e pemëve dhe perimeve për vitet 2019 dhe 2020 nga kompanitë përpunuese, vërejmë një rritje të konsiderueshme për vitin 2020. Sasia totale e perimeve të mbledhura për vitin 2020 ishin 20,500 ton, ndërsa e pemëve ishte 13,628 tonë.

Tabela 9: Grumbullimi i Pemëve dhe Perimeve për vitet 2019 / 2020

Grumbullimi i Pemëve dhe Perimeve për vitet 2019 / 2020				
Viti	2019	2020	Rritja	Diferenca* %
Perime	13,081	20,563	7,482	36%
Pemë	7,504	13,628	6,124	45%
Grumbullimi Total	22,604	36,211	13,607	37%

Sipas të dhënave, kompanitë e përpunimit të pemëve dhe perimeve furnizohen kryesisht me pemë dhe perime nga prodhuesit vendorë përmes kanaleve të ndryshme të furnizimit. Kompanitë e përpunimit, në varësi të llojit të kulturave bujqësore që mbledhin për përpunim, përdorin dy kanale kryesore furnizuese: direkt nga fermerët dhe indirekt, nga qendrat e grumbullimit të pemëve dhe perimeve. Duke marrë parasysh që furnizimi i shumicës së kompanive realizohet nga pikat e grumbullimit dhe drejtpërdrejt nga fermerët, është e nevojshme të vendosen marrëdhënie kontraktuale në mënyrë që të kemi një garanci që fermerët do t'i dorëzojnë produktet e tyre tek kompanitë përpunuese. Kompanitë e përpunimit kanë kontrata për furnizimin e pemëve dhe perimeve me 15 pika grumbulluese, afërsisht 1,300 kontrata jo të noterizuara me furnitorë dhe 600 fermerë me të cilët kompanitë e përpunimit nuk kanë kontrata. Anëtarët e Shoqatës PePeKo furnizohen kryesisht me lëndë të parë në nivel lokal, 94% e furnizimit të tyre vjen nga fermerët vendas dhe vetëm 6% vjen nga pemët dhe perimet e importuara.



Figura 7: Furnizimi me lëndë të parë




Figura 8:Furnizimi me lëndë të parë nga kompanitë*%

Të gjithë anëtarët e Shoqatës PePeKo kanë deklaruar se ata shesin prodhimet e tyre vendore në Kosovë përmes kanaleve të ndryshme të shitjes siç janë supermarketet, tregtarët me shumicë, shitës me pakicë, distributorë dhe forma të tjera të bashkëpunimit. Kompanitë kanë gjithsej 1,403 kontrata shitjeje ku 465 prej tyre janë me supermarketete, 330 me tregtarë me shumicë, 580 shitës me pakicë, 25 distributorë dhe 3 me kanale të tjera të shitjes kryesisht me kompani të tjera përpunuese.

Investimet dhe investimet e planifikuara në sektor

Vlera totale e investimeve për vitin 2019 dhe 2020 e deklaruar nga prodhuesit dhe përpunuesit vendor është rreth 7.5 milion Euro dhe bazuar në deklaratat e të investuarëve vlera totale e investimeve të planifikuara për dy vitet e ardhshme 2021 dhe 2022 do të jetë 8.6 milion Euro. Pjesa kryesore e investimeve që është bërë në vitin 2019 ishte e përqendruar në makineri dhe objekte të biznesit. Sidoqoftë, të gjitha kompanitë e intervistuar kanë prezantuar planet e tyre për rritjen e kapaciteteve të tyre në dy vitet e ardhshme, dhe si shkak ata planifikojnë të rrisin edhe numrin e furnizuesve të tyre. Ata gjithashtu besojnë se rritja e tyre në dy vitet e ardhshme do të ndodhë kryesisht për shkak të rritjes së kërkesës, qasjes më të mirë në treg, rritjes së prodhimit, përmirësimit të cilësisë dhe përmirësimit të kapaciteteve njerëzore.

Tabela 10: Investime dhe investimet e planifikuara në sektor

Investimet* €	Investimet 2019/2020	Investimet e planifikuar 2021/2022	Diferenca e Investimeve/Investimeve të planifikuara	Diferenca* %
Investimet totale	7,583,000	8,690,000	1,107,000	13
Makineri	4,327,050	4,598,000	270,950	6
Objektet punuese	2,396,500	2,935,000	538,500	18
Dhomat e ftohjes	263,150	810,000	546,850	68
Ndërtimi i kapaciteteve humane	20,000	77,500	57,500	74
Tjera	576,300	269,500	- 306,800	-114

Nëse shikojmë grafikun e më poshtëm në lidhje me investimet për vitet 2019/2020 dhe investime e planifikuara për vitet 2021/2022, është e qartë se kompanitë përpunuese do të rrisin investimet në sektor në mënyrë që të përmirësohen teknologjit ekzistuese të përpunimit. Nga përgjigjet e anëtarëve të Shoqatës PePeKo kuptohet që zhvillimi i sektorit të pemëve dhe perimeve u mbështet dhe u ndihmua nga shumë donatorë.

Gjatë mbledhjes së të dhënave me përfaqësues të biznesit, u diskutua për mbështetjen nga MBPZhR ku shumica e përfaqësuesve të kompanive deklaruan se ekziston mbështetje e mjaftueshme në forma të ndryshme si grante investimesh për industrinë përpunuese, si dhe subvencione për prodhimin primar. Sidoqoftë, skema e mbështetjes nuk po jep rezultate të kënaqshme për këtë sektor. Ata gjithashtu pohuan që kanë gjetur edhe mundësi të tjera për të financuar investimet e tyre në përpunim përmes donatorëve të jashtit si: Bashkimi Europian, Banka Botërore, USAID, PPSE, si dhe donatorë të tjerë, të cilët për sa i përket shpërndarjes së fondeve dhe granteve kanë bërë punë shumë më të mirë sesa institucionet lokale.




Figura 9: Investimet në industrinë e përpunimit të pemëve dhe perimeve

Shitjet: Vendore dhe Eksporti

Në vitin 2019 dhe vitin 2020 ka pasur një rritje të ndjeshme të shitjeve në tregun e brendshëm dhe të eksportit. Kjo mund të shpjegohet edhe nga fakti që në këtë studim kemi përfshirë edhe industrinë e përpunimit të patates e cila ka një ndikim të rëndësishëm në shitjet totale dhe eksportin e industrisë përpunuese. Nga të dhënat e mbledhura për vitin 2019, vlera totale e deklaruar e shitjeve është rreth 31 milion Euro, prej të cilave 21 milion Euro janë në tregun vendor dhe rreth 10.5 milion Euro janë shitje për tregun e jashtëm.

Meqenëse industria e patates shpesh konsiderohet si një industri përpunuese e ndryshme nga industria e përpunimit të pemëve dhe perimeve, në tabelën vijuese kemi prezantuar vlerën totale të shitjeve të eksportit pa (dhe me) patate. Bazuar në të dhënat e mbledhura nga kompanitë, vlera totale e eksporteve pa patate për vitin 2019 është rreth 6.5 milion Euro dhe në vitin 2020 vlera totale e shitjeve të eksportit pa patate është rreth 7.6 milion Euro.

Tabela 11: Shitjet, shitjet lokale dhe eksportuese

Viti	2019	2020	Rritja/ulje	Diferenca* %
Shitjet totale* €	31,054,000	32,648,000	1,594,000	5
Shitjet vendore* €	21,380,000	21,144,000	- 236,000	-1
Shitjet eksportuese *€	6,524,000	7,653,000	1,129,500	15
Shitjet eksportuese (përfshirë pataten)	9,674,000	11,503,500	1,829,500	16

Nga të dhënat e mbledhura nga terreni, kemi gjetur që 17 kompani eksportojnë produktet e tyre në vendet e rajonit dhe në tregjet e BE-së. Vendet kryesore ku kompanitë vendore eksportojnë janë: Gjermania, Zvicra, Italia, Austria, Finlanda, Belgjika, Shqipëria, Maqedonia e Veriut, Kuvajti, Katari si dhe ShBA-t.




Figura 10: Shitjet totale 2019 / 2020

Kompanitë anëtare të PePeKo-së janë përqendruar kryesisht në prodhimin e produkteve përfundimtare, por ka edhe kompani që shesin produktet e tyre si produkte gjysmëfinale dhe si lëndë e parë. Sipas përgjigjive të tyre, 16 ndërmarrje shesin të gjitha produktet e tyre si produkte finale, 4 kompani shesin produktet e tyre si lëndë të parë, 1 kompani shet produkte gjysmë-finale, dhe 2 kompani i shesin produktet në formë të kombinuar.

Konkurrenca e tregut dhe aktivitetet e promovimit

Meqenëse Kosova ka një treg të lirë, qasja në tregun kosovar për kompanitë e huaja është e lehtë, dhe kjo është një sfidë e vazhdueshme për kompanitë vendore të përpunimit kur bëhet fjalë për pozicionimin preferencial të produkteve të tyre në tregun vendor, duke ju shkaktuar konkurrencë e padrejtë nga mallrat e importuara. Shumica e kompanive të intervistuar kanë deklaruar se konkurrenca në tregun vendor është agresive nga kompanitë vendore dhe ndërkombëtare. Kur u pyetën kompanitë për identifikimin e konkurrencës, 15 prej kompanive deklaruan që kanë konkurrencë si nga kompanitë vendore ashtu edhe ato ndërkombëtare, 6 prej kompanive ndjenjë konkurrencë vetëm nga kompanitë e huaja, dhe 3 prej tyre vetëm nga kompanitë vendore. Kompanitë që kanë qenë pjesë e këtij studimi kanë deklaruar se në 5 vitet e ardhshme ata planifikojnë të rrisin eksportin e produkteve të tyre si rezultat i rritjes së kërkesës dhe konkurrencës. Një rritje e eksportit në sasi dhe vlerë do të arrihet përmes mekanizmave të ndryshëm siç janë: rritja e sasisë së prodhimit, zhvillimi i produkteve të reja, promovimi i produkteve në panairë ndërkombëtare, fitimi i tregjeve të reja si dhe prodhimi i produkteve të veçanta si produkte **“Private Label”**¹.

Meqenëse shumica e ndërmarrjeve të përpunimit të pemëve dhe perimeve kanë marrë pjesë në aktivitete promovuese lokale dhe ndërkombëtare si: panairë, misione shitjeje, takime B2B dhe forma të tjera të promovimit, ata sygjerojnë që forma të tilla promovuese duhet të vazhdojnë të mbështeten sepse është një formë e përshtatshme për të fituar tregje të reja dhe të marrin rezultate pozitive për veprimtarinë e tyre. Nga aktivitetet promovuese të organizuara nga GIZ, projektit **“Krijimi i Punësimit përmes Nxitjes së Eksportit”** kompanitë që kanë marrë pjesë në këto aktivitete kanë arritur rreth 162 kontrata të reja. Prej tyre, 16 kontrata të shitjes janë nënshkruar, 56 kontrata janë në proces negociimi dhe rreth 90 janë kontrata të mundshme bashkëpunimi që janë planifikuar për të ardhmen.

Kompanitë e intervistuar përgjatë periudhës kohore janar 2019 dhe dhjetor 2020 kanë marrë pjesë në disa aktivitete promovuese-panairë. Gjashtë kompani anëtare të shoqatës PePeKo në vitin 2019 me mbështetjen e GIZ, kanë marrë pjesë në panairin lokal të ushqimit dhe pijeve **“AGRO - KOS”**, dhe tre kompani të tjera kanë qenë pjesëmarrëse në një nga panairët më të mëdhenj në botë **“ANUGA”**, i organizuar nga agjencia **“KIESA”** dhe e mbështetur financiarisht nga GIZ, projektit **“Krijimi i Punësimit përmes Nxitjes së Eksportit”**. Me këtë rast GIZ ka mbuluar kostot për pjesëmarrësit dhe ekspozuesit në këtë panair përmes financimit të pjesshëm të kostove. Disa nga kompanitë vendore, kanë arritur që me sukses t'i përmbushin kriteret specifike të eksportit; ata kanë nënshkruar kontrata dhe tash e disa vite po eksportojnë në vendet europiane. Këto kompani duhet të shërbejnë si një frymëzim për kompanitë tjera, të cilat synojnë vendet e Europës dhe më gjërë.

¹ Produktet **“Private Label”** janë ato produkte që prodhohen nga një kompani për shitje nën markën e një kompanie tjetër.

Ndikimi i Pandemisë COVID-19 në sektor

Në shumë vende të botës, viti 2020 ka qenë një vit i vështirë kjo pasi që ekonomia globale është goditur nga Pandemia COVID-19. Padyshim, që ndikimi i kësaj Pandemie është ndjerë edhe në Kosovë, duke shkaktuar humbje të mëdha për ekonominë e vendit. Sipas informacionit të mbledhur, shumica e kompanive të përpunimit janë prekur drejtpërdrejt nga Pandemia, dhe shumë prej tyre madje kishin hasur vështirësi që në fillim të Pandemisë. Nga përgjigjet e marra për ndikim e Pandemisë në sektorin e përpunimit të pemëve dhe perimeve, nga 24 kompanitë e intervistuar, 19 prej tyre kanë deklaruar që kanë qenë të ndikuara nga Pandemia COVID-19 dhe 5 prej kompanive kanë deklaruar që nuk e kanë ndjerë efektin e saj. Kompanitë janë prekur në departamente të ndryshme si në prodhim, shitje, distribuim, dhe eksport. Ndikimi më i madh është njerë në sektorët e prodhimit, shitjes dhe distribuimit. Sa i përket punësimit dhe ndikimit të Pandemisë COVID-19 në punësim, 50% e kompanive deklaruan se ishin të detyruar të ndalonin ose ulnin përkohësisht orët e punës për punëtorët në mënyrë që të shmangnin kontaktet fizike dhe përhapjen e infeksionit midis tyre.

Pengesat kryesore të sektorit

Industria e përpunimit të pemëve dhe perimeve, si gjithë sektorët tjerë të bujqësisë, është përballur me sfida dhe probleme të ndryshme, sidomos gjatë vitit 2020 për shkak të Pandemisë COVID-19. Në vitin 2019 dhe vitin 2020 shumica e kompanive të përpunimit kanë pasur vështirësi në furnizimin me lëndë të parë. Sa i përketë mbjelljes dhe rendimentit të pemëve dhe perimeve për përpunim, viti 2020 ka qenë dukshëm më i favorshëm, por çmimi për lëndët e para ishte së paku 25% më i lartë për vitin 2020 në krahasim me vitin paraprak.

Rritja e çmimit të lëndës së parë është rezultat i dy faktorëve kryesorë: rritjes së kërkesës për eksportin e perimeve të përpunuara në tregjet e BE-së, si dhe rendimentit të ulët për hektar krahasuar me vendet në rajon. Në mënyrë që të rritet konkurrueshmëria e sektorit me importuesit, Shoqata PePeKo së fundmi ka paraqitur një kërkesë në MBPZHR për një subvencion shtesë nga 0,05 Euro për çdo kilogram pemë dhe perime të dorëzuara për përpunim në kompanitë vendore të përpunimit. Një tjetër problem i identifikuar nga kompanitë e përpunimit të pemëve dhe perimeve është pagesa e TVSH-së për lëndët e para të vendit, ndërsa lëndët e para të importuara përjashtohen nga TVSH-ja. Kohët e fundit, janë ndërmarrë hapa konkretë në këtë drejtim duke përfshirë në paketën e rimëkëmbjes ekonomike, një ndryshim ku lënda e parë që tregtohet në vend do të përjashtohet nga TVSH-ja, megjithëse ende nuk ka filluar të zbatohet.

Problemet e identifikuar me të cilat përballen kompanitë vendase janë të shumta për sa i përket qarkullimit të parave, pasi shumica e kompanive vendore përballen me vështirësi në mbledhjen e borxheve për produktet e shitura në rrjetet e supermarketeve vendore, si dhe detyrime të tjera financiare në formën e zbritjeve, pagesa për vendosjen e produkteve në raft, pagesa për hapjen e pikave të reja të tregut, pagesa me vonesë si dhe porosi të parregullta. Një problem tjetër i rëndësishëm i përmendur nga kompanitë është disavantazhi me të cilin përballen prodhuesit vendor kundrejt produkteve të importuara nga shitësit me pakicë. Shitësit me pakicë shpesh raportohet se i pozicionojnë produktet e importuara më mirë sesa produktet vendore, duke ndikuar në shitje të dobëta të produkteve vendore. Prodhuesit pohojnë që produkteve të tyre u jepet më pak hapësirë dhe vend i pafavorshëm në raftet e dyqenave krahasuar me ato të produkteve të importuara.

Një praktikë e tillë nuk është edhe në vendet e rajonit dhe më gjërë, sepse ata u japin pozicione më të favorshme produkteve vendore, dhe një praktikë e tillë sipas kompanive tona duhet të rregullohet me ligj edhe në Kosovë pasi që ata besojnë se kjo do t'i ndihmonte ata të rrisin shitjet e tyre.

Përveç problemeve të përgjithshme në lidhje me furnizimin, shitjet dhe procese të tjera, shumica e kompanive përpunuese kanë vështirësi edhe në gjetjen e fuqisë punëtore profesionale me përvojë të mjaftueshme për të kryer me sukses punët dhe detyrat e tyre. Profilet kryesore të fuqisë punëtore që janë mungesë në Kosovë janë përmendur në seksionin e punësimit të këtij studimi. Sidoqoftë, shumica e kompanive të intervistuar kanë deklaruar se investojnë në burime njerëzore duke ofruar mundësi trajnimi dhe avancimi për punëtorët e nivele të ndryshme, si për stafin drejtues ashtu edhe për punëtorët e tjerë në varësi të kërkesave të kompanive.

Duke marrë parasysh që viti 2020 ishte një vit shumë i vështirë, veçanërisht për industrinë ushqimore në botë, edhe sektori i përpunimit të pemëve dhe perimeve u prek nga Pandemia COVID-19. Nga 24 kompani të intervistuar, 19 prej tyre kanë deklaruar se janë prekur nga Pandemia kryesisht në departamentin e prodhimit dhe shitjeve, dhe disa kompani kanë pasur gjithashtu probleme edhe me eksportin e produkteve të tyre. Nga ana tjetër, 5 kompani të intervistuar deklaruan se aktiviteti i tyre ekonomik nuk është ndikuar nga Pandemia, madje ato kishin një performancë më të mirë ekonomike në vitin 2020 krahasuar me vitin e kaluar. Lidhur me punësimin, 50% e kompanive kanë deklaruar se për shkak të Pandemisë janë detyruar të pushojnë përkohësisht disa punëtorë ose të punësojnë më pak punëtorë në vitin 2020, krahasuar me 2019.

Pavarësisht problemeve aktuale me të cilat përballet sektori i pemëve dhe perimeve në Kosovë, shumica e anëtarëve të Shoqatës PePeKo besojnë se ka pasur përpjekje për të lobuar, avokuar ose ndikuar në ndryshimin e legjislacionit ose politikës në sektorin e përpunimit të ushqimit. Në të njëjtën kohë, shumica besojnë që duhet të ketë aktivitete dhe përpjekje avokimi dhe lobimi edhe më tutje, kryesisht në drejtim të reformës së politikës fiskale, skemës së mbështetjes së bujqësisë, financimit të kompanive bujqësore, ligjit dhe legjislacionit për mbrojtjen e prodhuesve vendor nga prodhuesit e huaj, mbështetja e bizneseve të grave, sigurimi i prodhimit bujqësor, si dhe në drejtim të programit më efikas të subvencioneve (p.sh. subvencionet ose heqja e TVSH-së dhe taksave të tjera në energji elektrike dhe naftë).

Rekomandimet

Duke marrë parasysh që investimet në bujqësi po rriten vazhdimisht në 5 vitet e fundit përmes skemave mbështetëse, në përgjithësi nuk pritet të ketë ndonjë zhvillim të rëndësishëm të bujqësisë. Skemat e mbështetjes nga qeveria duhet të rishikohen në mënyrë që të kenë një ndikim më të mirë në zhvillimin e bujqësisë, përkatësisht duhet të rishikohet Programi i Pagesave Direkte dhe Programi i Zhvillimit Rural. Meqenëse shumica e kompanive të përpunimit nuk përdorin më shumë se 50% të kapaciteteve të tyre ekzistuese dhe në anën tjetër, disa kompani të tjera të orientuara drejt eksportit nuk arrijnë të i përmbushin nevojat e tregut, bashkëpunimi midis kompanive të përpunimit të pemëve dhe perimeve brenda sektorit duhet të zgjerohet në të ardhmen. Përmes formave indirekte të mbështetjes për promovimin dhe hyrjen në tregjet e reja të produkteve vendore në vendet e huaja, MBPZhR duhet të konsiderojë mbështetjen e eksportit të produkteve të pemëve dhe perimeve përpunuara, sepse shumica e kompanive kanë arritur të depërtojnë në tregjet e BE-së dhe potenciali i rritjes së prezencës së produkteve kosovare në këto tregje është i lartë.

Rezultatet e mungesës së investimeve në burimet njerëzore kanë çuar në mungesë të profileve të specializuara, të tilla si teknolog, teknik laborator, inxhinier, etj. Prandaj, kompanitë duhet të rrisin investimet në burimet njerëzore, dhe nga ana tjetër, qeveria duhet të krijojë skema të mbështetjes dhe koordinimit midis kërkesës së tregut për profilet profesionale të punëtorëve dhe programeve të institucioneve arsimore publike dhe private në mënyrë që të plotësojë këtë boshllëk. Ky boshllëk mund të zvogëlohet përmes krijimit të “Programeve të Praktikave” për profilet e caktuara, krijimi i programeve arsimore të duhura për Shkollat e Arsimit Profesional si dhe aktivitete tjera. Pra, është e nevojshme të ekzistojë një koordinim më i mirë midis institucioneve arsimore si Universitetet, Shkollat e Mesme Profesionale, si dhe agjencitë e ndryshme arsimore në mënyrë që të plotësohet hendeku midis kërkesës për profile të caktuara në njërin anë, dhe punësimi i të rinjve të diplomuar nga universitetet dhe shkollat e mesme në anën tjetër. Këta hapa do të ndikojnë në uljen e hendekut midis kërkesave për profile profesionale dhe të diplomuarve të papunë.

Për të shmangur problemet me furnizimin e lëndëve të para për shkak të mosrespektimit të marrëveshjeve kontraktuale ndërmjet palëve kontraktuese, kontraktimi i noterizuar duhet të promovohet në mënyrë që palët të bien dakort paraprakisht për çmimet e produkteve, sasinë e furnizuar/marrjes dhe aspekte të tjera të rëndësishme të kontraktimit në mënyrë që furnizimi me lëndë të parë të mos mungojë. Duke marrë parasysh që shumica e kompanive eksportuese kanë si synim tregun e BE-së, standardet e sigurisë dhe cilësisë së ushqimit kërkohen të implementohen nga kompanitë. Ato duhet të investojnë më shumë në zbatimin e standardeve të cilat janë të detyrueshme ose vullnetare si HACCP, ISO 22000, IFS, BRC, etj.

Me qëllim të gjetjes së blerësve të rinj dhe partnerëve të rinj të mundshëm, aktivitetet promovuese duhet të vazhdojnë të mbështeten nga institucionet vendore dhe agjencitë lokale si KIESA, pasi që shumica e kompanive që kanë marrë pjesë në panairin ndërkombëtar si ANUGA, SIAL Paris, etj., kanë arritur rezultate konkrete duke nënshkruar marrëveshje kontraktuale me blerës nga vende të ndryshme të BE-së. Në mënyrë që të rritet produktiviteti i prodhuesve vendorë, MBPZhR duhet të ndërmarrë hapa konkretë duke subvencionuar prodhimin primar me mbështetje shtesë me 0,05 Euro për kilogram fermerëve të pemëve dhe perimeve që shesin prodhimet e tyre te kompanitë përpunuese. Kjo skemë mbështetëse do të ndihmojë kompanitë vendore të përpunimit të kenë një furnizim më të mirë të lëndëve të para nga fermerët vendor dhe do të përmirësojë zinxhirin e furnizimit të lëndëve të para midis prodhuesve vendorë dhe kompanive të përpunimit. Kjo skemë, gjithashtu do të ndihmojë edhe në përmirësimin e ekonomisë bujqësore dhe do të inkurajojë rritjen e produktivitetit dhe rendimentit për hektar.

Avokimi si një instrument për të kanalizuar problemet e sektorit dhe për t'i adresuar ato në institucionet e duhura duhet të jetë një aktivitet i vazhdueshëm. Prandaj, politikëbërësit dhe akterët tjerë të interesuar duhet të i trajtojnë këto vështirësi, në mënyrë që të përmirësohet zhvillimi i sektorit. Duke iu referuar problemeve të deklaruara në sektorin e pemëve dhe perimeve, Kosova duhet të marrë një sërë masash që do të ndihmonin industrinë e përpunimit të pemëve dhe perimeve. Megjithëse, kohët e fundit janë ndërmarrë disa hapa për të eliminuar TVSH-në për lëndët e para të prodhuara dhe tregtuara brenda vendit, ka ende nevojë për avancimin e politikave fiskale dhe avancimin e politikave bujqësore, veçanërisht skemën e granteve dhe subvencioneve.

Për më tepër, kompanitë kanë deklaruar se një hap serioz që duhet merret është rregullimi i ligjit për tregtinë e brendshme, pasi shumica e kompanive përpunuese janë jokonkurrese me kompanitë e huja të përpunimit, që jo rrallë herë bëjnë konkurrencë të pandershme ndaj prodhuesëve vendor. Shumica e kompanive vendore të përpunimit kanë një disavantazh konkurrense në krahasim me kompanitë nga rajoni sepse kompanitë e përpunimit në rajon kanë lehtësira dhe mbështetje të ndryshme nga shtetet e tyre, prandaj institucionet kompetente, përkatësisht departamentet e ndryshme të qeverisë duhet të marrin disa masa për të krijuar një mjedis më të mirë për të bërë biznes në Kosovë. Këto masa duhet të përfshijnë gjithë zinxhirin e vlerës, duke filluar me subvencionimin e fermerëve që shesin produktet e tyre për përpunim, pastaj përjashtimin e TVSH-së, subvencionim për karburant, gaz si dhe ulja e çmimit të energjisë elektrike, ujit dhe mbrojtjen e produkteve vendore në treg.

Konkluzionet

Nga rezultatet e prezantuara në raport dhe identifikimi i problemeve dhe sfidave të sektorit të përpunimit të pemëve dhe perimeve më poshtë do të përshkruajmë disa përfundime:

Në vitin 2019, ka pasur një rritje të lehtë të tokës së punueshme në krahasim me vitin 2018, me rreth 0.4%. Ka pasur një rritje të ndjeshme në sektorin e pemtarisë, ku bazuar në të dhënat e ASK-së, në vitin 2018 ka pasur 7,922 hektarë me pemë, ndërsa në vitin 2019 rreth 9,500 hektarë pemë, me rritje rreth 16%.

Shumica e anëtarëve të Shoqatës PePeKo, pajtohen që sektori i përpunimit të pemëve dhe perimeve përballet me probleme të ndryshme si: pagesa e TVSH-së për lëndët e para vendore (pemët dhe perimet), politika fiskale, furnizimi me lëndë të parë, vendosja e produkteve në tregun vendor dhe ndërkombëtar, pagesa dhe mbledhja e borxheve nga zinxhirët e tregut vendor, kushtet e kontraktimit (shitja, pagesa e pozicionit, pagesa për hapje të reja, etj.), mungesa e fuqisë punëtore të kualifikuar dhe me përvojë (teknolog, teknikë laboratorësh, mirëmbajtje, agjentë shitjesh, etj.), dhe gjithashtu aksesit në instrumentet financiare (kreditë e investimeve, normat e interesit, kushtet e huasë, çështjet administrative, etj.).

Kapacitetet prodhuese dhe përpunuese të deklaruara nga 7 kompani prej 24 kompani që morën pjesë në studim janë 55,000 tonë pemë dhe perime për vit dhe përdorimi mesatar i kapaciteteve të instaluar është rreth 50%. Objektet e deklaruara arrijnë gjithsej 35,000 metra katrorë ambiente pune me temperatura dhome, dhe rreth 20,000 metra katrorë dhoma magazinimi ftohëse prej -20 gradë Celsius deri - 40 gradë Celsius.

Anëtarët e PePeKo-së, shumica furnizohen me lëndë të parë nga prodhuesit vendor – 94% e furnizimit të tyre vjen nga tregu i brendshëm dhe vetëm 6% vjen nga importet. Prodhuesit vendor kanë grumbulluar një total prej 23,585 ton pemë dhe perime në vitin 2019, dhe 34,191 ton pemë dhe perime në vitin 2020, duke shënuar një rritje të konsiderueshme prej rreth 31 % në grumbullimin e pemëve dhe perimeve për vitin 2020, në krahasim me vitin paraprak.

Vlera totale e investimeve të deklaruara nga prodhuesit dhe përpunuesit vendor është rreth 7.5 milion Euro për dy vite ('19 dhe '20). Shumica e investimeve janë përqendruar në makineri dhe objekte të kompanisë. Të gjitha kompanitë e intervistuar besojnë se do të rrisin kapacitetet e tyre në të ardhmen e afërt, kryesisht për shkak të rritjes së kërkesës, qasjes më të mirë në treg, rritjes së prodhimit dhe përmirësimit të cilësisë. Sipas të dhënave, kompanitë pritet të investojnë rreth 8 milion Euro në dy vitet e ardhshme.

Edhe pse Ekonomia e Kosovës dhe PBB-ja kanë një rritje të lehtë ndër vite, prodhimi bujqësor fatkeqësisht ka mbetur në nivel jo të kënaqshëm. Vlera totale e PBB-së e është 7.103.8 milion Euro, dhe kontributi i kontributi i prodhimit bujqësor vlerësohet që është rreth 550 milion Euro, dhe merr pjesë vetëm me 7.7% në vlerën totale të PBB-së.

Megjithëse viti 2020 ishte një vit i vështirë për sa i përket shitjeve në tregun vendor, pati një rritje të eksporteve të deklaruara nga të gjitha kompanitë. Kjo rritje është rezultat i prishjes së lidhjeve të furnizimit në tregjet e BE-së, si dhe promovimit të produkteve vendore përmes pjesëmarrjes në panairë ndërkombëtare si ANUGA Cologne, SIAL Paris, etj. Pjesëmarrja në panairë është mbështetur nga donatorët si GIZ Kosova, USAID dhe donatorë të tjerë.

Për sa i përket certifikimit me standardet e sigurisë ushqimore, ekziston ende nevoja për të investuar dhe për të përmirësuar sigurinë e ushqimit përmes zbatimit të standardeve, pasi që gjysma e kompanive të intervistuar nuk zbatojnë ndonjë standard të sigurisë ushqimore si HACCP, ISO 22000, ose ndonjë tjetër standard.

Furnizimi me lëndë të parë mbetet një sfidë për kompanitë përpunuese pasi që shumica e kompanive nuk kanë garanci në lidhje me furnizimin me lëndët të para, sepse kontraktimi ndërmjet fermerëve dhe kompanive është thjeshtë formal dhe me kontrata të pa-noterizuara, dhe në shumë raste, këto kontrata nuk respektohet nga të dy palët.

Punësimi në sektorin e përpunimit të pemëve dhe perimeve është shumë i rëndësishëm, ku sipas të dhënave të ASK-së në sektorin e bujqësisë janë të punësuar drejtpërdrejt rreth 10,000 punëtorë në vit, ndërsa vetëm në industrinë e përpunimit të përfaqësuar nga Shoqata PePeKo në dy vitet e fundit numri i të punësuarëve ishte afërsisht 2,000 punëtorë në vit ose rreth 20% e punësimit në bujqësi.

Një sfidë serioze mbetet konkurrenca në tregun vendor nga produktet e importuara sepse në shumicën e rasteve çmimet e produkteve të importuara janë më të ulta se çmimet e produkteve vendore. Kjo ndodhë për arsye se çmimi i lëndëve të para në vendet e rajonit është më i ulët dhe kompanitë e përpunimit mund të shesin produktet e tyre më lirë se sa produktet e Kosovës. Gjithashtu në vendet e rajonit, ekzistojnë skema mbështetëse për kompanitë që eksportojnë produkte, me qëllim të rritjes së eksportit në vendin përkatës, zgjerimin e tregjeve dhe rritjen e konkurrueshmërisë.

Shumica e anëtarëve të Shoqatës PePeKo besojnë se duhet të ketë aktivitete dhe përpjekje avokimi dhe lobimi, kryesisht në drejtim të politikës fiskale, skemës së mbështetjes bujqësore, financimit, mbështetjes së bizneseve të grave, promovimit të eksportit, procedurave të eksportit, politika më të mirë të sigurimit të bujqësisë, legjislacioni që do të mbronte prodhuesit vendor nga prodhuesit e huaj, si dhe krijimi i një programi më efikas të subvencioneve (p.sh. subvencionet e fermerëve që dorëzojnë mallrat e tyre për përpunim në ndërmarrjet lokale me 0.05 Euro shtesë për kilogram, subvencione në energji elektrike dhe naftë, etj.).

Literatura

1. Berisha, V. (2018). Baseline Assessment on Current Situation for the Fruit and Vegetable Sector in Koso. Association of Fruits and Vegetables Processors in Kosovo PePeKo.
2. Miftari, I.(2019). Value chain in fruits and vegetable processing sector in Kosovo – PePeKo.
3. Gashi, H.(2020). Summary report of problems of the fruit and vegetable processing sector.
4. Kosovo Agency of Statistics, Agricultural Household Survey – 2019.
5. Ministry of Agriculture, Forestry and Rural Development - Green Report 2020.
6. Interviews with members of the PePeKo Association.